



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 043

KEC

E drejta për përfaqësim publik Avokimi

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Në vitin 2007 në kuadër të projektit “Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim” financuar nga Komisioni Evropian u mbajt trajnimi i parë për avokim, me qëllim të arritjes së ndryshimeve në gjithëpërfshirje dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Fillimisht u aftësuan 30 trajner nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkencës së Kosovës si dhe nga Qendrës për Arsim e Kosovës. Më pas u trajnuan për evokim 530 mësime të shkollave fillore në tërë Kosovën

Gjatë vitit 2010 programi i trajnimit për avokim është mbështetur nga OSI-Londër si pjesë e programit “Vendimmarrja e prindërve në arsim” e që ka për qëllim të kontribuoj në ndërtimin e një sistemi cilësor arsimor që promovon gjithëpërfshirjen dhe vlerat e shoqërisë demokratike. Programi ndihmon fuqizimin e prindërve për të marrë pjesë aktive në sistemin arsimor. Me këtë projekt janë trajnuar 170 pjesëmarrës të Këshillave të Prindërve të shkollave fillore.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:

- Kuptojnë konceptet kyçe mbi të cilat zhvillohet avokimi.
- Njihen me mënyrën e analizës së problemit, gjetjen e zgjidhjes, dhe përfaqësimin publik.
- Jenë në gjendje të mobilizohen dhe , të nxisin të tjerët të përkrahët kërkesa për marrjen e vendimeve.
- Njihen me format e avokimit

- Jenë në gjendje të përpilojnë planin e veprimit për një fushatë avokimi me pjesëmarrjen e të gjitha palëve me interes.

Përmbajtja e trajnimit

E drejta jonë për të avokuar. Konceptet kyçe që lidhen me avokimin. Përcaktimi për një çështje për avokim. Analiza e shkaqeve, situata e tanishme dhe situata e destinuar.. Kush janë palët me interes për çështjen e përcaktuar për avokim. Analiza e rrezikut. Buxheti dhe mundësitë financiare. Plani i veprimit, përfaqësimi publik.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet personave që kanë dëshirë të merren me çështje të avokimit, kryesisht individë, punëtorë të arsimit, grupe të prindërve si dhe organizata joqeveritare.

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi organizohet në formë të një seminari 2-3 ditor dhe ka gjithsej 16-24 orë. Numri optimal i pjesëmarrësve është 20-25.

Vlerësimi/ Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim, si dhe kryerja e detyrave që jepen gjatë trajnimit.

Materialet e trajnimit

KEC: *Udhëzues për avokim*